



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 3371/3 Prot.

Tiranë, më 04/10/2012

Lënda: Urdhër për Kontrolluesin "Gjykata e Rrethit Gjyqësor" Tiranë.

U R D H E R
Nr 02 ,datë 04/10/12

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit "Gjykata e Rrethit Gjyqësor" Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrit nr. 167 datë 20.09.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye inspektimi administrativ pranë kontrolluesit "Gjykata e Rrethit Gjyqësor" Tiranë me objekt:

- Verifikimi i ankesës së shtetases H.S drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e cila lidhet me publikimin e vendimit nr.1060 datë 09.02.2012 në të përditshmen "Gazete Shqiptare", vendim i cili mbart të dhëna personale të saj.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

Vendimi nr.1060 datë 09.02.2012, objekt i verifikimit të këtij inspektimi administrativ, që i përket shtetases H.S e cila ka bërë ankim me datën 15.09.2012 pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është publikuar në faqen zyrtare në, ashtu siç është në dosjen fizike të çështjes pa marrë masat e duhura për bërjen anonime të të dhënave personale të subjekteve që përfshihen në këtë vendim. Qëllimi i publikimit të këtij vendimi është transparenca dhe informimi publik.

Komisioneri vlerëson se duke bërë publike të dhënat personale të subjekteve të përfshira në këtë vendim shkelet privatësia e këtyre subjekteve të të dhënave personale, nuk respektohen dhe garantohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti e drejta e ruajtjes së jetës private, të drejta të cilat janë të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për "Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut" si dhe ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" duke qene në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” neni 2... “Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private”
- Udhëzimin nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”, Kreu IV “ Publikimi i të Dhënave Personale”

Konstatohet gjithashtu se nga “Gjykata e Rrethit Gjyqësor” Tiranë nuk janë marrë masat e duhura teknike e organizative për zbatimin e Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

URDHEROJ

1. Në zbatim të nenit 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe Kreut IV të Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”:
 - Të bëhet anonimizimi i të dhënave personale që i përkasin subjekteve të përfshira në Vendimin nr.1060 datë 09.02.2012 të publikuar në faqen e tuaj zyrtare në internet.
2. Të merren të gjitha masat e duhura teknike dhe organizative për zbatimin e Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor” për të realizuar anonimizimin e të dhënave personale që i përkasin subjekteve të përfshira në vendimet gjyqësore që publikohen në faqen zyrtare në internet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)
Në mungesë dhe me porosi

KËSHILLTARI

BESNIK PETRELA

